

## THIRRJE PËR APLIKIM PËR 2 (DY) SANITARE NË S.U.O.GJ. "KOÇO GLIOZHENI"

Bazuar në kreun III, pika 4 të Statutit "Për procedurat e marrjes në punë në S.U.O.GJ. "Koço Gliozheni" dhe në Vendimin e Bordit të spitalit Nr. 4 dt. 16.12 2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" si dhe urdhërit të brendshëm përkatës të drejtorit të Spitalit, shpallet thirrja për aplikim për pozicionin e lirë të punës "sanitare" në S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni".

**Dorëzimi i dokumentave bëhet nga datat 13-20 Nëntor 2023**

**pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni",**

**në adresën Blv. "Bajram Curri" 9 (sipër Brrylit), Tiranë (ora 9.00-16.00)**

### **Përshkrimi i detyrave dhe karakteristikave të punës:**

1. Sanitarja varet nga/dhe zbaton të gjitha urdhërat e dhëna prej kryemamisë.
2. Sanitarja pastron dhe lan të gjitha ambientet e spitalit, rregullon komodinat, rregullon shtretërit e të sëmurave.
3. Sanitarja ndihmon të sëmurat rëndë për kryerjen e nevojave fiziologjike në shtrat, ose i shoqëron ato për në tualet.
4. Sanitarja pastron të sëmurët rëndë dhe përgatit kushtet për të sëmurët e tjere (dushe, tualete, vaska).
5. Sanitarja grumbullon dhe largon mbeturinat nga reparti, duke i çuar në vëndin e caktuar dhe bën dezinfektimin e ambienteve, banjave.
6. Sanitarja ndihmon mamitë/infermieret për transportimin me barelë/ karrocë të të sëmurëve për kryerjen e ekzaminimeve.
7. Sanitarja ëërgjigjet për humbjet dhe dëmtimet në turnin e saj.
8. Sanitarja komunikon me familiarët e të shtruarve vetëm për problemet që lidhen me punën e saj.
9. Për çdo problem që ndodh në turnin e saj sanitaria lajmëron kryemaminë/maminë e turnit.
10. Sanitarja pastron shtatëzanen gjatë aktivitetit të lindjes dhe në orët më pas.
11. Kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me punën e saj, sipas udhëzimeve dhe urdhërave të eprorit.

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret si vijon:**

#### **Kritere të përgjithshme:**

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrat e përshkruara më sipër;
- c) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale;
- d) Të mos ketë masa disiplinore, që nuk u janë shuar efektet;

#### **Kritere të posaçme:**

- a) Të ketë kryer arsimin e detyrueshëm;
- b) Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe kërkesat dhe urdhërat e eprorëve dhe titullarit të institucionit;
- c) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe fleksibilitet në pranimin dhe përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve në dispozicion, aftësi shumë të mira të punës në grup dhe fleksibilitet në pranimin e nevojave, urdhërave dhe procedurave të punës.

## **Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", Tiranë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë me shkrim/Letër motivimi;
- b) Jetëshkrim (CV) të përditësuar, (ku të përfshihen të dhënat e kontaktit – numër telefoni/e-mail);
- c) Diplomat e shkollës, lista e notave /fotokopje të njehsuara me origjinalin
- d) Fotokopje të librezës së punës;
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID-së) ;
- f) Raport mjekësor për aftësinë në punë/vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimit shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.

*Dokumentet mund të jenë origjinale (me përjashtim të kërkesave specifike të listuara më sipër në pikën 3), apo të njehsuara me origjinalin.*

*Dokumentet e përfutuara në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njehsuara sipas ligjit.*

Aplikimi dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen/dërgohen në Zyrën e Arkivë-Protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", në adresën Blv. "Bajram Curri" 9 (sipër Brryllit), Tiranë brenda datës 20.11.2023 (ora 16.00).

Aplikantët që plotësojnë kriteret, nëpërmjet aplikimit dhe dokumentacionit përkatës, njoftohen individualisht për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të intervistës me gojë nga Sektori i Burimeve Njerëzore të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" në kontaktet e përcaktuara nga aplikantët në CV-të përkatëse.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me kriteret, përvojën dhe kualifikimin e lidhura me fushën e pozicionit të lirë të punës, si dhe gjatë intervistës me gojë lidhur me pritshmëritë, aftësitë, eksperiencën, kompetencën, motivimin dhe pritshmëritë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

Totali i pikëve është 40 dhe do të kryhet sipas tabelës së Shtojcës 1 të Vendimit të Bordit të spitalit Nr. 4 dt 16.12.2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" (bashkëlidhur njoftimit).

### **Dalja e rezultateve të konkurimit dhe komunikimi i tyre**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" do të shpallë fituesin në faqen e vet zyrtare. Fituesi do të njoftohet edhe nëpërmjet kontakteve të shënuara në aplikimin e paraqitur nga ana e këtij të fundit.